



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 5352/11 Prot.

Tiranë, më 09.07.2020

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1780, datë 12.11.2015.

SHOQËRISË “GERDA - 07” SH.P.K
Lagjia e Re, Blloku 4, Shkalla 3, Ap.8, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Për dëgjim: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “GERDA - 07” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1780, datë 12.11.2015, për mineral krom, në objektin “Zalli i Luçanës”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën Nr.1241/3, datë 13.07.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.5352, datë 15.07.2020, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1780, datë 12.11.2015, për mineral krom, në objektin “Zalli i Luçanës”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, sepse në objektin e pajisur me leje nuk është filluar aktiviteti minerar edhe pse ka 55 muaj që është dhënë kjo leje (data efektive e lejes Nr. 1780, është 12.11.2015), duke mos respektuar kërkesat e Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në paragrafin “ii” të gërmës “b”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1780, datë 12.11.2015, për mineral krom, në objektin “Zalli i Luçanës”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të Nr.1780, datë 12.11.2015, për mineral krom, në objektin “Zalli i Luçanës”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

